



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:191998
Datë: 25.11.2024
Numri i dokumentit: 06499681

K.DH.Sh II.nr. 1519/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha në çështjen përmbartimore të kreditorit “DLD Group” me numër unik identifikues 819841636 me seli në Prishtinë Lagja Pejton rr. “Perandori Justinian” Nr.25, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Hoti avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, rr. “UÇK”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.1442/23 të datës 28.06.2024, me datë 25.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1442/23 të datës 28.06.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1442/23 të datës 28.06.2024, ne dispozitiv ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 616/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërçagu dhe i njëjti urdhër Përmbartimor P.nr. 616/23, i lejuar me datë 24.08.2023, Mbetet në fuqi

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar, të ndryshoj aktvendimin e atakuar si e bazuar dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “DLD Group” SH.P.K., me datën 24.08.2023 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, në bazë të dokumentit të besueshëm faturës numër 2022/0018 dt.15.08.2022 në lartësi prej 1,000.00€.

Përmbartuesi privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr. 616/23 datë 24.08.2023, ka lejuar përmbartimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme faturës më numër 2022/0018, të datës 15.08.2022 në lartësi prej 1,000.00€, Urdhër pune i datës 15.08.2022 dhe Dokumenti i dorëzimit të faturës 2022/0018 me nr.prot.10-410/02-0218554/22 i datës 11.10.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,000.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes përmbartimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen të bëhet inkasimi i borxhit.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr. 616/23, të datës 24.08.2023 të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Fatura Nr. 2022/0018, të datës 15.08.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Dhe duke u bazuar në të lartcekurat, shkalla e parë lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura me nr. 2022/0018, të datës 15.08.2022 e përmban nënshkrimin e pranuesit së bashku me urdhëresën e punës në të cilën konfirmohet shërbimi

“Instalimi i E-Kioskut” , instalimi i programit të ri dhe pastrimi i Smart Hooper dhe NV200, i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbareshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbaresh sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbaresh duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbaresh të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbaresh organi përmbaresh, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbaresh, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbaresh, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbaresh dhe/apo atij të besueshëm, me ç ‘rast procedura sipas prapësimi i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase fatura si dokument i besueshëm në këtë rast paraqet titull ekzekutiv nga neni 29 par.1 pika 1.3 të LPP-së, dhe marrë parasysh faktin se kjo faturë është pranuar nga debitori që dëshmohet edhe nga formulari i kërkesës nr.protokolit 10-410/02-0218554/22 dt.10.22.2022, pretendimet e debitorit nuk paraqesin ndonjë provë se i njëjti ka kundërshtuar këtë faturë debitorit.

Përndryshe, në procedurën përmbaresh konfom parimit te rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaresh i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e Organit Përmbaresh që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbareshin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K. DH.Sh. II.nr.1519/24 me datë 25.11.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha